



**RREGULLORE E POSAÇME E KONTROLLEVE –  
INSPEKTIMEVE – ÇERTIFIKIMEVE TË  
ASHENSORËVE NË SHQIPËRI**



## RREGULLORE E POSAÇME E KONTROLLIT TË ASHENSORËVE NË SHQIPËRI

### PËRMBAJTJE

#### Kapitulli 1. Informacion i Përgjithshëm

- 1.1 Identiteti i Organit të Miratuar
- 1.2 Aktiviteti i Organit të Miratuar – Dokumenta Rregullatorë
- 1.3 Garantimi i Pavarësisë dhe Paanësisë
- 1.4 Garantimi i Konfidencialitetit
- 1.5 Tarifat e Inspektimeve (Shpërblimi për shërbimet e ofruara)

#### Kapitulli 2. Kushtet dhe Proçedura për Realizimin e Inspektimeve

- 2.1 Kushtet e Realizimit të Inspektimeve
- 2.2 Ofrimi i Informacioneve për të Interesuarit
- 2.3 Depozitimi i Kërkesës
- 2.4 Nënshkrimi i Ofertë - Kontratës
- 2.5 Inspektimi i ashensorit - Realizimi i Kontrollit, Inspektimit dhe i Provave Përkatëse
- 2.6 Vendimi i Çertifikimit – Lëshimi i Çertifikatës

#### Kapitulli 3. Të Drejtat dhe Detyrimet e Palëve të Përfshira


- 3.1 Rikontrollet pas gjetjes së mospërputhshmërive
- 3.2 Kërkesat e Sigurisë gjatë realizimit të inspektimeve
- 3.3 Ndryshime në kërkesa të inspektimeve
- 3.4 Përgjegjësia Civile
- 3.5 Detyrime kundrejt Organit të Miratuar për Çertifikime

#### Kapitulli 4. Ndryshimi, Pezullimi dhe Revokimi i Proçesverbalit të Inspektimit

- 4.1 Ndryshimi i Proçesverbalit të Inspektimit
- 4.2 Pezullimi i Çertifikimit
- 4.3 Revokimi i Çertifikimit
- 4.4 Informimi i Organeve Shtetërore

#### Kapitulli 5. Kundërshtime / Ankesa / Dyshime

- 5.1 Ankesa dhe Dyshime
- 5.2 Kundërshtime

 <b>ERGOCERT ALBANIA</b> AUDITIME · INSPEKTIME · ÇERTIFIKIME	<b>RREGULLORE E POSAÇME PËR KONTROLLIN E ASHENSORËVE NË SHQIPËRI</b>	
	ver. 7	Data e hyrjes në fuqi: 15/03/2023
		Kodi: Rregullore e Posaçme_01_AL

## KAPITULLI 1 – INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

### 1.1 IDENTITETI I TRUPËS SË AKREDITUAR ose ndyshe quajtur - ORGANIT TË MIRATUAR

ERGOCERT HELLAS A.E është një Trupë e Akredituar nga Sistemi Kombëtar i Akreditimit të Greqisë (E.ΣY.Δ) dhe është gjithashtu një Trupë Inspektimesh e Njoftuar pranë Komisionit Europian (Nando Notified Body European Commission me No. 2421)

#### Ofrimi i shërbimeve të Kontrollit të Ashensorëve në Shqipëri, realizohet nga:

Emërtimi: ERGOCERT HELLAS A.E.

Adresa: KEFALINIAS 2, K. POSTAR 54627 SELANIK GREQI

Nr. Identifikimi Tatimor: 998756358

Email: info@ergocert.gr

Përfaqësuar nga Presidenti dhe Drejtori i Bordit z. Spyro Liako.

Trupa e Akredituar ERGOCERT HELLAS A.E, në mënyrë që të ushtrjë aktivitetin e saj në tregun shqiptar, ka regjistruar në Shqipëri degën e saj të emërtuar Ergocert Albania, degë e shoqërisë së huaj, e cila është miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë të Shqipërisë si:

- OM 010 – Vendimi Nr. 46 dt. 25.06.2021 «Inspektimi përfundimtar dhe vendosja e Markimit CE – Verifikimi i Njesisë dhe vendosja e Markimit CE». Neni 18-23 ligji 10489/dt. 15.12.2011 dhe VKM 192 /dt. 04.04.2018.
- OM 011 – Inspektimi Tipi A. Vendimi Nr.47. dt. 25.06.2021 «Ekzaminimi i plotë dhe inspektim periodik i ashensorëve» - Neni 18-23 ligji 10489/dt. 15.12.2011 dhe VKM 1056/dt. 23.12.2018 e ndryshuar.

#### Marrëdhënia tregtare dhe financiare me klientët në Shqipëri realizohet nga:

Emërtimi: ERGOCERT ALBANIA (Degë e shoqërisë së huaj ERGOCERT HELLAS A.E.)

NUIS L64709602F

Selia në adresën: Rr. Thanas Ziko, Nr. 75, Pall. «Vaso1», Shk-A, Ap. 1/84

Njësia Bashkiake 8 - Tiranë

Përfaqësues ligjor, administrator z. Vasil Papajani.


### 1.2 Aktiviteti i Organit të Miratuar – Dokumenta Rregullatorë

Aktiviteti i ERGOCERT HELLAS A.E. ose shkurt, ERGOCERT, që formalizon kjo Rregullore e Posaçme, është ai i kontrollit fillestar me anë të procedurave të vlerësimit të tipit të egzaminimit “EE”, të egzaminimit përfundimtar, të përpunshmërisë në bazë të kontrollit të çdo komponenti në ashensorë të rinj të instaluar në Shqipëri (*dmth., për ashensorë të instaluar rishtazi, të pa vendosur në përdorim*) për të vlerësuar përputhshmërinë e tyre me kushtet dhe kriteret e çertifikimit për vendosjen e Markimit CE, si ato parashikohen në Direktivën 2014/33/EE, në Standartet e Harmonizuara për ashensorët dhe direktivat udhëzuese që jepen nga Drejtoria e Akreditimit (EΣYΔ) dhe nga Komisioni Europian, si ato janë akoma në fuqi.

Gjithashtu, aktiviteti i ERGOCERT, që formalizon kjo Rregullore e Posaçme, është edhe inspektimi, me procedura vlerësimi për egzaminim të plotë, inspektim periodik, në ashensorë të instaluar dhe vendosur në përdorim, për vlerësimin e përputhshmërisë së tyre me kushtet dhe kriteret e çertifikimit si ato parashikohen në legjislacionin shqiptar sipas VKM 1056 dt. 23.12.2015 në fuqi, për ashensorët në përdorim.

Aktiviteti i detajuar i OM, realizohet sipas parashikimeve në këtë Rregullore të Posaçme dhe sipas Procedurës së Vlerësimit të Ashensorëve (Δ3) të Organit të Miratuar, si ato janë në fuqi.

#### Në Shqipëri janë në fuqi gjithashtu dhe:

 <b>ERGOCERT ALBANIA</b> AUDITIME · INSPEKTIME · ÇERTIFIKIME	<b>RREGULLORE E POSAÇME PËR KONTROLLIN E ASHENSORËVE NË SHQIPËRI</b>	
	ver. 7	Data e hyrjes në fuqi: 15/03/2023
		Kodi: Rregullore e Posaçme_01_AL

Ligji 10489 dt.15.12.2011 (i ndryshuar), Kapitulli V, ku parashikohen Organet e Miratuara (OM) të cilat ushtrojnë aktivitetin dhe të drejtën e Kontrollave/inspektimeve/çertifikimeve të produkteve joushqimore (në rastin konkret të ashensorëve). Në këtë kapitull të ligjit, parashikohet aktiviteti dhe procedura e miratimit të tyre (të OM-ve) nga Ministria përkatëse, në rastin konkret nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

- VKM 192 dt. 4.4.2018 Për miratimin e rregullit Teknik për ashensorët dhe komponentët e sigurisë për ashensorët dhe përcaktimin e listës së standarteve të harmonizuara për ashensorët e rinj që nuk janë vendosur në përdorim sipas Direktivës 2014/33 të Komisionit Europian dhe të Standartit 81:20, e cila, përcakton rregullat teknike të kontrolleve, çertifikimeve dhe të Markimit CE për ashensorët e rinj që instalohen në Shqipëri pas vitit 2018 si dhe procedurat e regjistrimit të tyre (të ashensorëve) pranë ISHMT-së (Inspektoriati i Mbikqyrjes së Tregut),
- VKM 1056 dt 23.12.2015 “Për miratimin e rregullit Teknik për sigurinë e ashensorëve në përdorim”, e cila përcakton rregullat teknike për kontrollin dhe çertifikimin fillestar dhe periodik të ashensorëve si dhe procesin e regjistrimit pranë ISHMT-së, për ashensorët e rinj dhe në përdorim.

Të gjithë ashensorët e instaluar në Shqipëri, do të duhet të përmbushin kriteret që janë miratuar nga dy VKM-të e sipërcituara. Për kontrollin e përmbushjes së rregullave teknike, (më anë të realizimit të kontrolleve, sipas rastit, të ashensorëve të vënë në përdorim dhe ata të rinj) me ligjin 10489/15-12-2011, janë ngarkuar Trupat e Akredituara të cilat në fund, miratohen nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë si OM (Organe të Miratuara). Këto Organe të Miratuara, inspektojnë ashensorët e rinj dhe ata në përdorim sipas parashikimeve të dispozitave ligjore të VKM 192 dt.4.4.2018 (ashensorë të rinj) dhe VKM 1056 dt. 23.12.2015 (për ashensorët e vënë në përdorim).

ISHMT (Inspektoriati Shtetëror i Mbikqyrjes së Tregut), është një organ shtetëror (një strukturë përgjegjëse) në varësi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, e cila ka kompetenca për të ushtruar kontrolle në tregun e ashensorëve në të gjithë territorin e Shqipërisë. ISHMT-ja, është themeluar me VKM 36 dt. 20.01.2016 «Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoriatit Shtetëror të Mbikqyrjes së Tregut». Në pikat 4.1 dhe 2 të VKM-së 192/4.4.2018, parashikohet: Vendosja në treg, bërja e disponueshme në treg dhe vendosja në shërbim. **Struktura përgjegjëse e mbikqyrjes së tregut (në vijim, ISHMT) merr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar se ashensorët e mbuluar nga ky rregull Teknik, mund të vendosen në treg dhe në shërbim vetëm nëse ato janë në përputhje me këtë rregull teknik, kur instalohen, mirëmbahen dhe përdoren brenda qëllimit të tyre të parashikuar. Në rastin kur Çertifikata e Konformitetit është lëshuar nga ana e Organit të Miratuar që ka inspektuar përfundimisht instalimin e ashensorit, atëherë pronari i këtij ashensori i drejtohet ISHMT-së dhe kërkon Regjistrimin e Ashensorit të Inspektuar dhe Çertifikuar.**

### 1.3 Garantimi i Pavarësisë dhe Paanësisë

- 1.3.1 H ERGOCERT HELLAS SA (si dhe Ergocert Albania si degë e shoqërisë së huaj e regjistruar në Shqipëri) është një Trupë Inspektimesh dhe Çertifikimesh (më tej OM-ja) e cila e realizon aktivitetin e saj, nëpërmjet Inspektorëve / kontrolluesve të akredituar dhe të autorizuar për realizimin e inspektimeve dhe të kontrolleve përkatës.
- 1.3.2 Politikë e Ergocert është që të ofrojë shërbimet e saj të Inspektimeve dhe Çertifikimeve në mënyrë të tillë që të garantojë pavarësinë dhe paanësinë e saj dhe të përforcojë besimin e tregut në punën e saj.
- 1.3.3 Shërbimet e Ergocert janë të ofrueshme lirisht kundrejt të gjithë klientëve të interesuarve (persona fizikë/juridikë apo individë), pavarësisht statusit që gëzon klienti (pronësor/biznes i madh ose i vogël, etj) kështu duke garantuar shërbime duke i trajtuar klientët e saj në mënyrë të barabartë. Të gjithë klientët dhe në përgjithësi palët e interesuara, nuk i nënshtrohen kërkesave financiare abuzive ose të pajustificuara por trajtohen në mënyrë të barabartë nën frymën e respektit reciprok dhe paanësisë.
- 1.3.4 Staf i ekzekutiv i OM-së dhe të Komisioneve përkatëse që janë ngritur, nuk mbajnë asnjë marrëdhënie të palejuar me klientët, për llogari të të cilëve realizojnë inspektime dhe kontrolle të ashensorëve dhe nuk u lejohet të angazhohen karshi tyre në asnjë mënyrë që mund të ndikojë në objektivitetin e gjykimit dhe



paanshmërinë e tyre. Aktivitete të tjera profesionale të personelit të OM-së, nuk duhet në asnjë mënyrë të ndikojnë në paanshëmërinë e tyre.

- 1.3.5 Om-ja, stafi i saj, Inspektorët si dhe anëtarët e Komisioneve të Posaçme përkatëse, janë të lirë dhe të pavarur nga çdo presion dhe angazhim tregtar, financiar apo çdo angazhim tjetër, që mund të ndikojë në korrektësinë e vlerësimit/gjyqimit të tyre Teknik.
- 1.3.6 Stafi i OM-së, nuk vepron kurrë në një mënyrë të tillë që mund të vërë në dyshim pavarësinë, paanshëmërinë dhe integritetin që ka për detyrë të tregojë OM-ja drejt çdo pale që ka interes të ligjshëm në lidhje me vënien në punë dhe përdorimin e ashensorit të ri të inspektuar.
- 1.3.7 OM-ja dhe personeli i saj, nuk janë në asnjë mënyrë të përfshirë drejtpërdrejtë ose tërthorazi me aktivitete që kanë të bëjnë me projektimin, prodhimin, furnizimin, instalimin, blerjen, pronësinë, përfaqësimin, përdorimin apo mirëmbajtjen e ashensorit që inspekton.
- 1.3.8 Inspektorët/Kontrolluesit nuk ofrojnë asnjë shërbim të natyrës këshilluese, trajnuese ose ekspertize gjatë procedurave të inspektimit ose kontrollit të një ashensori.
- 1.3.9 Shpërblimi i personelit pjesëmarrës në aktivitetet që lidhen me inspektimin e AShensorit, nuk varen dhe as ndikojnë në rezultatet e këtyre inspektimeve.
- 1.3.10 Stafi i OM-së, detyrohet që çdo informacion që disponon ose do të vijë në dijeninë e tij, në lidhje me kontrollet dhe provat e realizuara si dhe në lidhje me çdo lloj inspektimit me objekt ashensorët, si dhe çdo informacion që lidhet me marrëdhënien e OM-së me klientët, përfshirë dhe informacionin që përbën të drejta intelektuale, të mos e shpërndajë te persona të tretë që nuk kanë autorizimin e nevojshëm nga OM-ja dhe nga legjislacioni përkatës.

#### 1.4 Garantimi i Konfidencialitetit

- 1.4.1 OM-ja merr përsipër dhe siguron që çdo informacion në lidhje me produktin e inspektuar dhe prodhuesin dhe/ose pronarin e tij, i cili merret gjatë kryerjes së kontrolleve, testeve dhe inspektimeve të ashensorëve, të mbahet konfidencial në të gjitha nivelet e funksionimit të OM-së.
- 1.4.2 OM-ja informon autoritetin njoftues si parashikohet në paragrafin 4.4 më poshtë.
- 1.4.3 OM-ja, bazuar në Direktivën Evropiane 2014/33/EE u ofron organeve të tjera të notifikuara, të cilët kryejnë aktivitete të ngjashme të vlerësimit të konformitetit dhe mbulojnë të njëjtin tip ashensori, informacionin përkatës që ka të bëjë me rezultatet negative dhe nëse u kërkohet dhe pozitive, të vlerësimit të konformiteteve.
- 1.4.4 Në rastet kur ka arsye për njoftim apo dhënie informacioni të autoriteti njoftues ose te organe të tjera, OM-ja nuk kushtëzohet nga autorizimi i mëparshëm i klientit për informimin, transferimin apo dhënien e informacionit.
- 1.4.5 Për të siguruar sa më sipër, stafi përkatës i OM-së informohet për këtë dhe është i detyruar të rrespektojë konfidencialitetin e informacionit që i vihet në dijeni, si dhe pavarësinë nga interesat ekonomike, gjatë nënshkrimit të Deklaratës së Pavarësisë dhe Konfidencialitetit, në të cilën detyrohen të deklarojnë çdo lidhje, marrëdhënie të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, me persona (organizata ose persona fizikë/juridikë) të lidhur me inspektimin që kanë marrë përsipër të realizojnë.

#### 1.5 Tarifat e Inspektimeve (Shpërblimi për shërbimet e ofruara)

- 1.5.1 Tarifat e Inspektimeve (Shpërblimi për shërbimet e ofruara), si dhe koha dhe mënyra e pagesës së tyre si dhe çështje të tjera që lidhen me marrëdhënien ekonomike por dhe me shërbimet e ofruara, përcaktohen në ofertën ekonomike – kontratën e inspektimit lidhur mes OM-së dhe Klientit.
- 1.5.2 Kusht i domosdoshëm për përfundimin e procedurave të kontrollit, inspektimit, provave, të lëshimit të raporteve jopërfundimtare, të rezultateve të provave të atyshme, të raporteve përfundimtare dhe të lëshimit të çertifikatave, është që të provohet nga klienti, pagesa e plotë, në kohën dhe mënyrën e duhur, e detyrimeve financiare të tij, (pagesa e shpërblimit të shërbimit – tarifa e inspektimit) kundrejt OM-së, për ofrimin e shërbimit të kontrollit dhe inspektimit të ashensorit, në shumën monetare të përcaktuar në ofertën



ekonomike. Gjithashtu, ky kusht është i pavarur nga natyra dhe rezultati (pozitiv apo negativ) i raporteve jopërfundimtare dhe përfundimtare të inspektimit të ashensorit (të shërbimit të ofruar).

- 1.5.3 Në rast se, Inspektorët / Kontrolluesit e OM-së, pas konsultimit me klientin, përgatiten për realizimin e një inspektimi në vendndodhjen e instalimit të një ashensori, në një kohë të caktuar dhe/ose shkojnë në vendndodhjen në kohën e rënë dakord, dhe klienti anulon premtimin e gatishmërisë së tij në minutën e fundit, pa informuar të paktën 24 orë përpara për pamundësinë e kryerjes së inspektimit, atëherë, përveç detyrimeve të klientit kundrejt OM-së, që sipas kërkesë ofertës ekonomike fillestare ngelen të pacënuara, klienti do të ngarkohet me një vlerë shtesë prej 50% më shumë të vlerës së ofertës fillestare.
- 1.5.4 Në çdo rast, mos rrespektimi i kushteve të kësaj rregulloreje dhe i atyre të ofertë – kontratës për ofrimin e shërbimeve dhe veçanërisht mospagesa e detyrimit financiar nga ana e klientit kundrejt OM-së, (pagesa e tarifës së inspektimit – pagesa e shërbimit) për shërbimet e ofruara, përbën dhe është i barabartë me dhënie autorizim pa asnjë rezervë drejt OM-së nga klienti, për kalimin e të drejtës nga klienti drejt OM-së, që kjo e fundit të mos njohë asnjë detyrim karshi klientit për shërbimet e ofruara, si të mos egzistonte më parë një marrëveshje bashkëpunimi dhe ofrimi shërbimesh.

## KAPITULLI 2 – KUSHTET DHE PROCEDURAT PËR REALIZIMIN E INSPEKTIMEVE

### 2.1 Kushtet e Realizimit të Inspektimeve

- 2.1.1 Kontrollat, inspektimet, provat dhe matjet përkatëse që ushtrohen në ashensorë, realizohen në përputhje me kërkesat e veçanta të çdo kategorie të vlerësimit të konformitetit, të referuara në objektin e fushës zyrtare të zbatimit të konformiteteve të Organit të Akredituar dhe me kushtin se gjithçka do të përputhet plotësisht me parashikimet e Rregullores së këtushme.

### 2.2 Ofrimi i Informacioneve për të interesuarit

- 2.2.1 Të interesuarit për realizimin e inspektimeve në ashensorë, që janë kompetencë dhe bëjnë pjesë e fushës së vlerësimit nga Organi i Miratuar, mund të marrin, pa pagesë, të gjithë informacionin e nevojshëm nëpërmjet kësaj Rregulloreje të Posaçme. Informacione dhe sqarime të mëtejshme për zbatimin e Rregullave të Miratuar, jepen në formë verbale nga Drejtuesi Teknik, përfaqësuesi ligjor dhe nga inspektorët e autorizuar.

### 2.3 Depozitimi i Kërkesës

- 2.3.1 Të interesuarit për realizimin e inspektimeve, depozitojnë një kërkesë, të plotësuar dhe nënshkruar nga vetë ata (për individët dhe personat fizikë) ose nga përfaqësuesit e tyre (për personat juridikë).

- 2.3.2 Kërkesa e mësipërme duhet të përmbajë ose t'i bashkëlidhet, të paktën:

- Identiteti dhe adresa e Instaluesit, ose e pronarit të godinës si dhe të dhënat e duhura për plotësimin dhe lëshimin e faturës tatimore të shërbimit nga OM.
- Të dhënat e plota të ashensorit/rëve që do të inspektohen si dhe të zbatimit të standarteve të prodhimit të tyre, nëse ato janë të njohura nga kërkuesi.
- Përcaktimi i saktë i kategorisë së inspektimit që kërkohet, në varësi të kategorizimit të llojeve të inspektimeve sipas paragrafit 1.2 më lart.
- Projekt-studimi i plotë dhe Dosja Teknike e çdo ashensori që kërkohet të inspektohet.
- Deklarata e kërkuesit se bie dakort me kushtet e këtij Rregulli të Posaçëm të Kontrollit.
- Deklaratë përgjegjësie e kërkuesit se një kërkesë e njëjtë nuk është bërë te një OM tjetër.
- Çdo dokument tjetër provues që prezumon përmbushjen e standarteve të prodhimit të ashensorit/rëve me Direktivën 2014/33/EE, të përmbushjes së standarteve të harmonizuara dhe të përmbushjes së kushteve dhe kërkesave të inspektimit që ka paracaktuar OM-ja.

- 2.3.3 Kërkesa kontrollohet për plotësimin e saj nga personeli i autorizuar i OM-së. Gjithashtu kërkesa mund të kontrollohet me çdo mënyrë që vlerësohet nga OM, dhe për vërtetësinë e informacionit që përmban.



Plotësimi me të dhëna të rreme i jep të drejtën OM për rrefuzimin e kërkesës ose të ndërprerjes në mënyrë të njëanshme të inspektimit që gjendet në zhvillim e sipër ose të revokimit të Raportit të Inspektimit ose dhe të Çertifikatës së lëshuar.

## 2.4 Nënshkrimi i Ofertë – Kontratës

2.4.1 Pas dorëzimit të kërkesës për inspektim dhe shqyrtimit dhe pranimit të saj nga OM-ja, Ofertë - Kontrata nënshkruhet nga palët kontraktuese, pra nga OM-ja dhe klienti. Ofertë - Kontrata përbën marrëveshjen përfundimtare tregtare që përfshin të gjitha të drejtat dhe detyrimet e dy palëve lidhur me shërbimin e kërkuar për kryerjen e kontrollit - inspektimit të ashensorëve.

## 2.5 Inspektimi i ashensorit - Realizimi i Kontrollit, Inspektimit dhe i provave përkatëse

2.5.1 Pas pranimit të ofertës së OM-së nga Klienti, Drejtuesi Teknik ose Përgjegjësi i Sektorit, jep urdhër drejt Inspektorit përkatës, për fillimin dhe realizimin e inspektimit të ashensorit. Në këto raste:

2.5.1.1 OM-ja, cakton inspektorët/kontrolluesit e posaçëm përkatës. Inspektorët/ kontrolluesit e posaçëm përcaktojnë nevojat dhe kërkesat e kategorisë specifike të inspektimit sipas Rregullores së Posaçme, Proçedurave të Përgjithshme, Proçedurave Teknike dhe/ose Udhëzimeve të Punës përkatëse, dhe përgatiten në përputhje dhe në varësi të rrethanave.

2.5.1.2 Inspektorët/kontrolluesit, për të dokumentuar përshtatshmërinë e të dhënave teknike të ashensorit, fillimisht vlerësojnë dosjen teknike të dorëzuar bashkë me aplikimin apo pranimin e ofertës, përta i përket kërkesave të përcaktuara në Direktivën e Kontrollit të Dosjeve Teknike të Ashensorit e cila është në formën e një liste inspektimi. Dokumentat që kontrollohen në mënyrë indikative janë: leja e ndërtimit, deklarata e inxhinierit për mjaftueshmëri statike, studimi inxhinierik, studimi inxhinierik, çertifikatat e ekzaminimit të llojit ose projektimit, diagramet elektrike dhe hidraulike, elementët e sigurisë të konstruksionit etj.

2.5.1.3 Inspektorët/kontrolluesit identifikojnë dhe përzgjedhin të dhëna e duhura për kryerjen e inspektimeve në vendndodhjen e instalimit të ashensorit në fjalë dhe sigurojnë përshtatshmërinë e pajisjeve të punës dhe pajisjeve mbrojtëse personale për zbatimin e inspektimeve dhe të matjeve.

2.5.1.4 Në rast se ashensori nuk përmbush kushtet që vendos OM-ja, (*siguria, pastërtia, mungesa të tjera, etj.,*) atëherë OM-ja mund të rrefuzojë realizimin e inspektimit.

2.5.1.5 Inspektorët/kontrolluesit realizojnë kontrollet, inspektimet dhe matjet përkatëse dhe plotësojnë gjetjet/rezultatet në fletët dhe/ose raportet përkatëse të kontrollit dhe të matjeve.

2.5.1.6 Inspektorët/kontrolluesit kryejnë sërish një inspektim përfundimtar të dosjes teknike të ashensorit për të krahasuar të dhënat teknike të dosjes me të dhënat teknike të marra nga këqyrja në vendin e instalimit të ashensorit.

2.5.1.7 Inspektorët/ kontrolluesit, nëse vërtetojnë se ndërmjet klientit dhe OM-së, janë plotësuar të gjitha kushtet të kësaj rregulloreje, atëherë mund të dalin me një raport referimi për inspektim.

2.5.1.8 Inspektorët/kontrolluesit kur sipas gjykimit të tyre rezultatet e kontrollit-inspektimit janë të pranueshme dhe rekomandojnë OM-në për lëshimin e çertifikatës, përgatisin çertifikatën përkatëse në formë drafti.

## 2.6 Vendimi i Çertifikimit – Lëshimi i Çertifikatës

2.6.1 Përgjegjësi i Vlerësimit shqyrton rezultatet e inspektimit/kontrollit të ashensorit, plotëson formularin Shqyrtim i Inspektimit dhe Vendim i Çertifikimit dhe ia përcjell rekomandimin e tij Drejtuesit Teknik. Drejtuesi Teknik shqyrton të dhënat kundrejt kërkesave të procesit të OM-së. Drejtuesi Teknik në varësi të rezultatit të shqyrtimit, miraton ose jo dhënien e çertifikatës së ashensorit bazuar në rekomandimin e inspektorit si Shqyrtim Inspektimi dhe rekomandimit të Përgjegjësit të Vlerësimit si formulari i Vendimit të Çertifikimit.

2.6.2 Rrefuzimi i lëshimit të çertifikatës apo rrefuzimi i lëshimit të raportit të inspektimit, argumentohet, përcakton arsyet e saj dhe njofohet menjëherë te klienti.

2.6.3 Nuk lejohet riprodhimi i Çertifikatave të lëshuara.



- 2.6.4 Qartësohet se, lëshimi i Çertifikatës nuk jep miratim apo leje për vënien në punë të ashensorit përkatës. Një miratim i tillë jepet vetëm sipas parashikimeve ligjore nga organi kompetent shtetëror shqiptar.
- 2.6.5 Çertifikatat e kontrolleve fillestare në ashensorë të rinj, janë të vlefshme për periudhë të pacaktuar kohore.
- 2.6.6 Çertifikatat Origjinale përfundimtare njoftohen direkt nga OM-ja.

## KAPITULLI 3 - TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE TË PËRFSHIRA

### 3.1 Rikontrolle pas gjetjes së mospërputhshmërive

- 3.1.1 Ashensori që gjatë realizimit të kontrollit – Inspektimit, vlerësohet se nuk përmbushë kondformitetet, mund të riinspektohet, nëse janë përfunduar riparimet korrigjuese që përbëjnë dhe arsyen e rrefuzimit përkatës.
- 3.1.2 OM-ja mban të drejtën të ushtrojë kontrolle dhe prova shtesë, nëse vlerëson se veprimet riparuese vendosin në dyshime rezultatin e kontrolleve të mëparshme.
- 3.1.3 Klienti njofton për sa më sipër dhe pranon dhe detyrohet të përshkruajë plotësisht dhe në mënyrë të qartë drejt OM-së, të gjitha veprimet riparuese të cilat ka realizuar.

### 3.2 Kërkesat e Sigurisë gjatë realizimit të inspektimeve

- 3.2.1 Objekti (Ashensori) në kuadër të inspektimit dhe gjatë kontrolleve në vendndodhjen e instalimit, duhet të jetë në gjendje të tillë për realizimin e inspektimit, në mënyrë që të realizohet kontrolli/inspektimi me siguri dhe në përputhje me udhëzimet e veçanta të punës O 01.

### 3.3 Ndryshime në kërkesa të inspektimeve

- 3.3.1 Nëse kërkesat në fuqi për llojet dhe tippet e inspektimeve që mbulohen nga çertifikata e akreditimit të OM-së, ndryshojnë, atëherë OM-ja njofton menjëherë klientin për këtë fakt, duke përcaktuar dhe datën e hyrjes në fuqi të ndryshimeve dhe e informon në lidhje me çdo veprim shtesë inspektimi.
- 3.3.2 OM-ja, është e detyruar të ushtrojë kontrolle bazuar në dokumentacion ligjor dhe rregullator, si ai është në fuqi, duke përshtatur procedurat e tij si parashikohet nga Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë që ka përvetësuar.
- 3.3.3 Nëse OM-ja konstaton se nuk ka vullnet (nga klienti) për të pranuar ndryshimet ose nëse rezultatet e ndonjë kontrolli/inspektimi shtesë nuk janë pozitive, atëherë Çertifikata e lëshuar do të pushojë së qeni e vlefshme nga data efektive e ndryshimeve të njoftuara/përcaktuara nga OM-ja, përveç rasteve kur vendoset ndryshe nga një autoritet kompetent.

### 3.4 Përgjegjësia Civile

- 3.4.1 Shërbimet e ofruara nga OM-ja, mbulohen nga policë e sigurimit për përgjegjësinë civile.

### 3.5 Detyrimet kundrejt Organit të Miratuar për Çertifikime

- 3.5.1 Lëshimi i Raportit të Inspektimit ose të Çertifikatës nuk përbën dhe as nënkupton në asnjë mënyrë, miratim për vënie në përdorim të ashensorit të inspektuar.
- 3.5.2 Nuk lejohet që çertifikatat e lëshuara nga OM-ja, të përdoren në mënyrë të tillë që të perceptohet si praktikë mashtruese.
- 3.5.3 Ndalohet riprodhimi i Çertifikatës.
- 3.5.4 Klientët e OM-së duhet të lejojnë dhe ofrojnë lehtësirat përkatëse për Inspektorët/Kontrolluesit e Organit Akreditues (E.SY.D) për të kryer këta të fundit kontrollet përkatëse.
- 3.5.5 Logoja e Organit Akreditues (ESYD) nuk mund të vendoset mbi produktet e gatshme ose në komponentë ose në pjesët e tyre, as të përdoret në një mënyrë të atillë që nënkupton miratimin e produktit nga (ESYD).

## KAPITULLI 4 - NDRYSHIMI, PEZULLIMI DHE REVOKIMI I PROCESVERBALIT TË INSPEKTIMIT



#### 4.1 Ndryshimi i Proçesverbalit të Inspektimit

4.1.1 OM-ja vlerëson kërkesën e klientit për ndryshim të çertifikatës, duke ndjekur të njëjtën procedurë si në rastin e kërkesës fillestare.

#### 4.2 Pezullimi i Çertifikatës

4.2.1 OM-ja mund të pezullojë fuqinë / vlefshmërinë e çertifikatës së lëshuar, për një periudhë të caktuar, për disa arsye, si më poshtë:

- › Në rastet e përdorimit në keqbesim ose në mashtrim të Çertifikatës me mënyrë të tillë që çënon OM-në dhe Organin e Akreditimit (ΕΣΥΔ) dhe në mungesë të veprimeve të tjera të duhura korigjuese të kësaj situate,
- › Në raste të shkeljes së kushteve të kësaj Rregulloreje,
- › Në raste të mos përmbushjes së kushteve financiare ose të kushteve të tjera të ofertë – kontratës të lidhur mes OM-së dhe Klientit.

#### 4.3 Revokimi i Çertifikatës

4.3.1 Përveç pezullimit, si parashikohet në procedurat përkatëse të OM-së, Çertifikata mund të revokohet në rastet e mëposhtëme:

- › Nëse klienti nuk përmbush detyrimet financiare të tij ose shkel detyrime të tjera të Ofertë – Kontratës mes klientit dhe OM-së,
- › Nëse, si përshkruhet në paragrafin 3.3 të kësaj rregullore, klienti nuk dëshiron të përshtatet me kërkesat e ndryshimeve të standartit të zbatueshëm,

4.3.2 Pezullimi/Revokimi i dërgohet me e-mail ose me dërgesë postare (ose me mënyrë tjetër të barazvlefshme) duke përcaktuar qartë arsyet. Ky veprim i njoftohet dhe organit shtetëror mbikqyrës si është ISHMT-ja.

4.3.3 Nëse është i nevojshëm pezullimi/revokimi i Çertifikatës, do të duhet që klienti të njoftohet paraprakisht sipas mënyrës së parashikuar në tabelën më poshtë:

Arsyet që justifikojnë njoftim për pezullim/revokim/shfuqizim të Çertifikatës	Afatet e njoftimit para pezullimit/revokimit/shfuqizimit të Çertifikatës
Dëshira e "Klientit" (i kontrolluari)	Jo më pak se 30 ditë para
OM-ja, vëren më vonë, nëpërmjet procedurave të cilësisë që mban, se është bërë një gabim gjatë inspektimit.	Menjëherë
Mos pagesë e detyrimeve financiare të klientit	Jo më pak se 10 ditë para
Shkelja e detyrimeve të tjera kontraktore	Jo më pak se 60 ditë para
Përshtatje e detyrueshme me kërkesat e reja në lidhje me standartin e rishikuar ose të dispozitave rregulluese ligjore	Me marrëveshje

#### 4.4 Informimi i Organeve Shtetërore

4.4.1 OM-ja informon autoritetin njoftues për sa më poshtë:

- Rrefuzimin, kufizimin, pezullimin ose revokimin e çertifikimeve.
- Për situata që ndikojnë në fushën e zbatimit ose të kushteve të njoftimit.
- Për kërkesa të mundshme që marrin nga autoritetet mbikqyrëse të tregut për informacion lidhur me aktivitetin e vlerësimit të konformiteteve.
- Nëse u është kërkuar lidhur me aktivitetet të vlerësimit të konformiteteve që realizojnë në kuadër të njoftimit të tyre dhe lidhur me çdo aktivitet tjetër, përfshirë dhe aktivitetet ndërkuftare dhe ato të nënkontraktimeve.



4.4.2 Në ratet kur egziston një arsye për njoftim ose ofrim informacioni si në paragrafin e mëparshëm, OM-ja nuk kushtëzohet dhe detyrohet nga një dakortësi apo autorizim i mëparshëm i klientit të cilit i është lëshuar çertifikata, për transferimin ose informimin ose dhënien e çdo informacioni. Megjithatë, mundet që të informojë klientin brenda një kohe të arsyeshme për transferimin e informacionit ose dhënien e informacionit.

## KAPITULLI 5 – KUNDËRSHTIME/ANKESA/DYSHIME

### 5.1 Ankesa dhe Dyshime

5.1.1 Ankesat dhe dyshimet në lidhje me shërbimet e ofruara nga OM-ja, do duhet të bëhen më shkrim dhe të depozitohen nga palët e interesuara. Ankesat dhe dyshimet e depozituara, vlerësohen nga Drejtuesi Teknik I OM-së, në përputhje me Proçedurat e Ankesave dhe Kundërshtimeve. Nëse vlerësohen të bazuara, atëherë OM-ja, vijon me veprimet korrigjuese dhe në çdo rast, informon me shkrim ankuesin.

### 5.2 Kundërshtime

5.2.1 Kundërshtime lidhur me vendime të OM-së **ERGOCERT HELLAS A.E (Ergocert Albania degë e shoqërisë së huaj)**, përfshirë të vendimeve për lëshimin e Çertifikatës Rrefuzuese, mund të bëhen me shkrim dhe të depozitohen nga pala e interesuar brenda një (1) muaji nga njoftimi i vendimit të ankimit ose nga data kur kanë marrë dijeni të këtij vendimi.

5.2.2 Kundërshtimet e sipërcituara, vlerësohen në përputhje me Proçedurat e Ankesave dhe Kundërshtimeve të OM-së. Për hetimin dhe vendimin për ankesat & kundërshtimet, ngrihet Komisioni i Kundërshtimeve dhe Ankesave i përbërë nga tre anëtarë.

5.2.3 Vendimi mbi ankesën merret brenda 30 ditëve nga depozitimi i saj, është përfundimtar dhe i njoftohet me shkrim ankuesit.

### HISTORIKU I NDRYSHIMEVE TË DOKUMENTIT

A/A	Data	Botimi / Ndryshimet	Përgjegjës	Miratimi
01	15.02.2011	Botimi fillestar i Rregullores	ΥΔΠ	Dretori i Bordit
02	31.05.2018	Ndryshimet e tabelës 1.2	ΥΔΠ	Dretori i Bordit
03	20.09.2019	Shtesa në tabelën 1.2 në të dhënat e prodhimit të ashensorit	ΥΔΠ	Dretori i Bordit
04	22.07.2020	Ndryshime të tabelës 1.2	ΥΔΠ	Dretori i Bordit
05	17.09.2022	Ndryshim i Aneksit A - riemërtimi në Rregullore të Posaçme	ΥΔΠ	Dretori i Bordit
06	03.02.2023	Ndryshime § 2.5 - referohen në mënyrën e lëshimit të çertifikatës (arsyetimi dhe vendimi i çertifikimit)	ΥΔΠ	Dretori i Bordit
07	15.03.2023	Ripërcaktimi – Ndryshimi i të dhënave	ΥΔΠ	Dretori i Bordit